

# NJË RIT I VEÇANTË I TRASHËGIMISË SONË KULTURORE NË RREZIK ZHDUKJE

Muharrem ABAZAJ

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Veçorit që e dallojnë një komb nga kombet e tjera, përveç trojeve, gjuhës, simboleve kombëtare, janë edhe veshjet, këngët e vallet, ritet e ndryshme (riti i lindjes, martesës, vdekjes etj). Kombet e kulturuar bëjnë të gjitha përpjekjet që këto trashëgimi kulturore t’i ruajnë në përjetësi, duke përjetësuar kështu kombin e tyre. Ritet zënë një vënd të veçantë në trashëgimie kulturore të kombit tonë.. Do të ndalemi këtu vetëm tek njeri prej tyre, tek riti i vdekje, krysisht tek ceremonili i vajtimit. E kemi veçuar këtë rit, pasi ai gati është në zhdukje. Ka disa dekada që ky rit ka pushur ceremonialin e lashtë të tij siç kanë qenë gjama në Veri dhe vajtimi me kujë në Jug.

*Fjalë kyce: rit, vajtim, e lashtë, arë.*

## ABSTRACT

The features that distinguish a nation from other nations, in addition to lands, language, national symbols, are also clothing, songs and dances, various rites (rite of birth, marriage, death, etc.). Cultured nations make every effort to preserve these cultural heritages forever, thus perpetuating their nation. Rites occupy a special place in the cultural heritage of our nation. We will stop here only at one of them, at the rite of death, mainly at the mourning ceremony. We have singled out this rite, as it is almost extinct. It has been several decades since this rite ceased its ancient ceremonial, such as the mourning in the North and the mourning in the South.

*Key words: ritual, lamentation, ancient, planted land.*

## NJË RIT I VEÇANTË I TRASHËGIMISË SONË KULTURORE NË RREZIK ZHKUKJEJE

Vajtimi duhet të jetë nga ritet më të lashta të njerëzimit. Me largimin nga jeta të personave të ndryshëm njeriu është përballur që nga periudhat më të lashta të ekzistencës së tij. Referuar autorëve të antikitetit këtë rit e vërejmë që në kohën e Luftës së Trojës, tek Odiseja e Homerit, tek tragjeditë e Eskilit etj. Si një komb shumë i lashë edhe tek ne ky rit duhet të jetë i tillë. Por, ashtu si për gjuhën, edhe për këtë rit, nuk kemi të dhëna përtej shek XVI. Por sot kemi mundësinë të ndriçojmë këtë rit të lashtë nëpërmjet gjuhës së lashtë shqipe. Duke u përpjekur për një kohë shumë të gjatë, kam arritur të deshifroj një numër të konsiderueshëm mbishkrimesh të lashta të cilat shkojnë disa shekuj p.e.s dhe që janë gjetur dhe janë në ruajtje në një territor shumë të gjerë, ku përfshihet Lindja e Mesme, Pellgu i Mesdheut, Gadshulli Ballkanik, Gadishulli Apenin e më tej. Të gjitha këto mbishkrime deshifrohen vetëm me anën e gjuhës tonë, por me një shqipe shumë arkaike. Arsyeja pse këto mbishkrime lidhen të gjitha me gjuhën shqipe, spjegohen me faktin e lidhjes, e vazhdimësisë gjuhësore pellazgo – iliro – shqipe. Nga materiali gjuhësor i këtyre mbishkrimeve kemi mundur të njohim veçorit kryesore të shqipes së lashtë. Fjalët e shqipes së lashtë kanë qenë njërrokëshe. Ato kanë patur trajta të ngurtësuar, pasi në atë periudhë shqipja nuk i ka patur në përdorim mjetet gjuhësore si parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjet, të cilat u japin fjalëve ndryshueshmëri, fleksibilitet. Disa nga fjalët më të lashta të saj kanë qenë at (babë) am (nënë), bi (bir) ar (arë, tokë e punëshme), ba (me ba) la (me la) le (me le, lind), il (yll) i (Zoti) etj. Pasurimi I fjalorit të sa, në mungesë të këtyre mjeteve gjuhësore, është bërë duke përngjitur fjalët njërrokëshe. Kështu emri **Dimal** është formuar nga përngjitja e dy fjalëve njërrokëshe: di – mal. Fjala **di** ka kuptimin e numërorit dy, kurse fjala **mal** atë të emrit mal. Kuptimi emrit del “Dy male“. Fjala **arban** është formuar nga përngjitja e dy fjalëve njërrokëshe: ar – ban. Fjala **ar** ka kuptimin e arës, tokë e punuar, e vënë nën kulturë. Fjala **ban** ka kuptimin e foljes bën, por është në trajtën e dialektit të gegënishtes. Kuptimi i fjalës del: “ *Arë ban, bën arë* “. Me këtë veçori është bërë dallimi, emërtimi i banorëve ilirë të trojeve

tona, si njerëz shumë të aftë për t'u marrë me punën e arave, me bujqësi. Vdekjen, këtë mister të madh, njerëzit e lashtë e kanë parë jo si një zhdukje përfundimtare të personit të vdekur, por si një largim të tij nga kjo jetë. Këtë largim ata e kanë konceptuar si udhëtim të këtij personi tek Krijuesi, tek Zoti, në botën e përtejme. Kadareja thotë: “bota e përtejme, ka qenë me hyrjet dhe daljet që andej të personazheve, vajtjet atje të bujtësve të gjallë, e kthimit që andej të të vdekurve e kështu me radhë bota e amaneteve, e kumteve dhe lajmeve të dërguara me anë zogjsh, resh a qyqesh, nga trevat e vdekjes në ato të jetës ose e kundërta” Dhe ceremoniali i vajtimi, në tërësinë e tij, ka qenë i lidhur me Zotin, me lutjet që i bëheshin atij për ta marrë pranë personin e tyre të dashur që po ikte nga kjo botë. Dhe, duke qenë se ne kemi arritur ta njohim saktësisht si është thirrur Zoti nga banorët e lashtë të trojeve tona, e dallojmë saktësisht lidhjen e ritit të vajtimit me emrin e Zotit. Emrin e Zotit e kemi identifikuar në shumë mbishkrime të lashta të gjetura jo vetëm në vendin tonë, por edhe në ato vende që përmendëm më lart. Trajta zanafillëse e emrit të Zotit ka qenë shprehur vetëm me zanoren *i*. Nuk arrijmë të kuptojmë pse pikërisht me këtë zanore është emërtuar Zoti, por vëmë re se me zanoren *i*, në gjuhën e lashtë shqipe është shprehur edhe përemri vector i vetës së tretë, ai. Kemi dëgjuar shpesh në gjuhën e popullit përdorimin e shprehjes “Të vraftë ai” në vend që të thuhet “Të vraftë Zoti”.

Emërtimi zanafillës, i Zotit në gjuhën shqipe, si shumë fjalë të shqipes së lashtë, ka patur evolucionin e vet. Në fillim përpara kësaj zanore është shtuar bashktingëllorja *h*. dhe ka dalë trajta *Hi*. Për analogji po sjellim edhe raste të tjera evoluim fjalësh të shqipes së lashtë. Folja *ha* në zanafillë ka patur trajtën *a*, folja *hap* ka patur trajtën *ap* etj. Me kalimin e kohës tek fjala *Hi* kemi një ndryshim tjetër, zanorja *i* del me një alternim tjetër tingëllor, me zanoren *z*, dhe emri del në trajtën *Hy*. Edhe për këtë alternim po sjellim shembuj të tjerë analogë: emri *sy* në shqipen e lashtë ka patur trajtën *si*, numërori *dy* ka patur trajtën *di*, emri *kry* ka patur trajtën *kri* etj, trajta këto që ruhen ende në disa krahina të vendit tonë. Gjuha e sotme shqipe është bërë një gjuhë e zhvilluar. Ajo ka ruajtur rrenjën e trajtave të fjalëve të shqipes së lashtë, por ka vënë në zbatim elementet gjuhësore si parashtesat, prapashtesat, mbaresat, nyjet të cilat u japin fjalëve ndryshueshmëri, fleksibilitet. Kështu edhe fjala e shqipes së lashtë *Hi*, kur përdoret në trajtën e shquar merr në fund zanoren *i*. dhe del trajta *Hyi*. Por me që kjo trajtë ka një difekt tingëllimi, për arsye të diftongut *yi*, midis këtyre dy zanoreve ka hyrë bashktingëllorja *j* dhe trajta e sotme del *Hyji*. Me këtë emër e njohim Zotin vetëm ne shqiptarët. E njohim sepse ne jemi pasardhës të pellazgëve dhe pellazgët, ashtu si i kanë thirrur të gjithë autorët e antikitetit, kanë qenë pellazgë hyjnorë. Le të kthehemi tani tek ceremoniali i vajtimit. Unë kam qenë qindra herë i pranishëm në ceremonitë e vajtimit në jug të vendit tonë, ose në kujet si quhen ato. Elementi bazë i kujës është të qarit me *oi* të grave. Kjo fillon me pjestaret gra të familjes së njeriut që largohet nga jeta dhe më pas kalon në një qarje kolektive, me pjesmarrjen e shumë grave të afërta të këtij personi.

## PËRFUNDIME

Kjo pasthirmë *oi*, *oi*, e përsëritur shumë herë, ruan të paprekur atë trajtë thirrjeje të të parëve tanë. Ajo përfaqëson thirrjen që ata i bënin Hyjit tek të cilët pasthirma *o* shoqërohej nga emri i Hyjit, emri i të cilit në lashtësi, ashtu si thamë më lart, thirrej vetëm me zanoren *i* të zgjatur. Nëse vërejmë me kujdes edhe fjala *kuje* është një fjalë e shqipes së lashtë. Ajo është e përbërë nga përngjitja e dy fjalëve njërrrokëshe. Fjala *kuje* është formuar nga ndajfolja e vendit *ku* dhe folja me qenë *je*. Kuptimi i saj është: “*Ku je?*”, dhe kuptohet lehtë se kjo thirrje i adresohet Hyjit. Përfundimish themi se riti i vajtimi me *oi* është një rit shumë i lashtë që është përcjellë brez pas brezi në trojet tona dhe vazhdon të ruaj të pacënuar trajtën e tij origjinale. Do të jetë me shumë vlera që këtë rit të veçantë të trashëgimisë tonë kulturore, Instituti përkatës në Akademinë e Studimeve Albanologjike, ta rindërtojë dhe ta rregjistronte sa nuk është vonë. Materialet e plotësuara t’ia përcjellë UNESKO-S për ta përfshirë në fondin e trashëgimisë kulturore botërore, ashtu si është vepruar me iso polifoninë.

## **STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA**